

VENDIM
Nr. 644, datë 1.10.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRJETIT
KRYESOR TË KANALIZIMEVE DHE IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË PËRDORURANË PLAZHIN E VELIPOJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe impiantit të përpunimit të ujërave të përdorura në plazhin e Velipojës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë pemëtore, me sipërfaqe prej 17 870 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 309 000 (treqind e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Investime”, i planifikuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e projektit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, dheme fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së projektit të objektit në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 SEKTORI I SHPRONËSIMIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
 DREJTORIA E PROJEKTEVE IPA

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË
 UJËRAVE TË PËRDORURA PËR ZONAT E VELIPOJËS

FSHATI “PULAJ” ZK.3072, SHKODËR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Sipërfaqja (m2)	TOKË pemëtore		Vlera totale (lekë)	Shënime
								çmimi (leke/m²)	vlera (lekë)		
1	Emiljan	Nik	Nika	3072	966/7	8,050	8050	262	2109100	2109100	Konfirmim ZVRPP
2	Luigj	Dede	Suka	3072	966/5	9,820	9820	262	2572840	2572840	Konfirmim ZVRPP
3	SHUMA						17870		4681940		